

Prof. Dr. Brikena Leka

Prof. Dr. Brikena Leka është e punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 27 vjeçare si pedagoge dhe studiuese. Pas diplomimit në degën e Financë-Kontabilitetit, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1998, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushën e Financave Personale.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Financat e Familjes dhe Financat e Biznesit.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare/ndërkombëtare, ku më së fundmi: Edukimi Financiar i Studentëve, financuar nga UT (22.05.23-22.11.24); Green FIB/ Enhancing knowledge of EU green finance policies insurance and business valuation. Jean Monett (01.10.23-30.09.26); USE IPM/ Up-skilling researchers for sustainable entrepreneurship based on innovation process management. Horizon (01.07.23-30.06.27); 1FUTURE/ jOINED For sUstainability – bUilding climate Resilient communities in WB and EU. Erasmus + (01-04.23-21.03.26).

Ka shërbyer si anëtare e Komisionit të Doktoraturave në FEUT, për periudhën: 2021-2023.

Është bashkëautore në libra dhe cikël leksionesh në fushën e Financës dhe Financave Personale.

Ka botuar artikuj shkencorë në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka mbajtur kumtesa në konferenca brenda dhe jashtë vendit, duke numëruar më shumë se 45 të tillë.

Është anëtare në borde shkencore, borde editorial si dhe reviu për artikuj shkencorë dhe punime shkencore të paraqitura në konferenca, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.